

BIO E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

EDMOND COKU

Edmond Coku ka një përvojë të gjerë ndërkombëtare në fushën e investimeve strategjike. Ai është i specializuar në ndërtimin e ekipeve, krijimin e strategjive për daljen në treg dhe hartimin e planeve operacionale për shtrirje të përshkallëzuar, për disa nga kompanitë më të mëdha në tregun e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Z. Coku ka një ekspertizë të spikatur në manaxhimin e Lehman Brothers Equity/GP Ownership në DE Shaw dhe GLG Partners. Ai është një person me gjykim gjithëpërfshirës dhe me aftësi të spikatura në biznes.

Z. Coku është anëtar i besuar bordi i Fondacionit të Universitetit Amerikan në Kosovë (RIT Kosovo) (2015-deri më sot) dhe Këshilltar në Këshillin e Presidentit në Manhattanville College (2012 - deri më sot).

Z. Coku ka një diplomë Master në Administrim Biznesi nga Stanford Graduate School of Business dhe një diplomë Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Financë (me dy degë) nga Manhattanville College i New York-ut, SHBA.